

4 maj 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) të datës 30.08.2023, si dhe në trajtim të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të datës 27.04.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), me datë 04.05.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. SHQIPTOHET dënim me të holla në vlerë prej 300.00 EUR ndaj klubit KB Proton Cable Prizreni, për shkelje të lehtë disiplinore sipas Nenit 46(2)(c) të Rregullores Disiplinore të FBK-së, për deklarata publike që lidhen me performancën e gjyqtarëve ose ndonjë zyrtari të ndeshjes;
- II. Masa ka efekt ndalues dhe edukues, duke pasur për qëllim të parandalojë çdo deklaratë publike të ngjashme në të ardhmen që mund të cenojë rregullin, respektin dhe integritetin e garave të organizuara nga FBK;
- III. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Më datë 27.04.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), përmes postës elektronike, ka pranuar kërkesën për inicim të procedurës disiplinore ndaj KB Proton Cable Prizreni (tash e tutje “Kërkesa”), lidhur me postimet e datës 10 dhe 22 prill 2026, të publikuara në rrjetet sociale të klubit përgjatë serisë së ndeshjeve finale të Ligës së Parë Meshkujt, edicioni 2025/26.

Në përputhje me aktet në fuqi, KD ka autorizuar administratën e FBK-së që, në bazë të Nenit 38 të Rregullores Disiplinore të FBK-së (“RRD”), të kërkojë deklaratë me shkrim nga Klubi lidhur me rrethanat e rastit.

Më datë 04.05.2026, KD ka mbajtur mbledhjen shqyrtuese të rastit. Materialet, provat dhe dokumentacioni relevant kanë qenë paraprakisht në dispozicion të Komisionit, përfshirë komunikatën zyrtare të datës 19.04.2026, videon e publikuar nga Klubi më 22.04.2026, si dhe deklaratën me shkrim të dorëzuar nga Klubi.

Në funksion të trajtimit të lëndës, KD ka analizuar të gjitha dokumentet dhe provat në dispozicion, si dhe bazën përkatëse ligjore dhe rregullative, dhe ka konstatuar si në dispozitiv për arsyet e mëposhtme.

KD ka marrë në shqyrtim postimet publike të KB Proton Cable Prizreni të publikuara në rrjetet sociale gjatë periudhës së ndeshjeve finale, përfshirë komunikatën zyrtare (më 19 prill 2026) dhe materialin video (më 22 prill 2026), në të cilat klubi shpreh pakënaqësi dhe kritika lidhur me vendimet e organeve të FBK-së, rrjedhën e garës, si dhe elemente të ndryshme të administrimit dhe zhvillimit të ndeshjeve, përfshirë edhe çështje që ndërlihen me vendimmarrjen gjatë lojës.

Në vlerësimin juridik të rastit, KD ka konstatuar se dispozita përkatëse që trajton situatën në fjalë është Neni 46, paragrafi 2, pika (c) i Rregullores Disiplinore të FBK-së, i cili përcakton:

2. Shkelje të lehta në lidhje me menaxhimin dhe administrimin e garave konsiderohen këto si në vijim:

[...]

(c) Deklarata publike, përfshirë ato të bëra në rrjetet sociale ose çdo mjet komunikimi, që lidhen me performancën e gjyqtarëve ose ndonjë zyrtari të ndeshjes.

KD vlerëson se postimet e Klubit, të cilat përmbajnë qëndrime dhe komente lidhur me performancën e gjyqtarëve, bien në mënyrë të qartë në fushën e aplikimit të Nenit 46(2)(c) të RRD-së dhe përbëjnë shkelje të lehtë disiplinore.

Komisioni thekson se në kuadër të një sistemi të organizuar sportiv, çdo pakënaqësi lidhur me vendimmarrjen e gjyqtarëve duhet të trajtohet përmes kanaleve zyrtare dhe procedurave të brendshme të FBK-së, dhe jo përmes deklaratave publike. Praktikrat e tilla cenojnë standardet institucionale dhe mund të ndikojnë negativisht në perceptimin e integritetit të garës.

Në vlerësimin e masës disiplinore, KD ka marrë parasysh rrethanat konkrete të rastit, duke përfshirë faktin se veprimet e Klubit duket të kenë qenë rezultat i një reagimi impulsiv, se nuk është konstatuar qëllim për dëmtim të integritetit të garës apo nxitje të dhunës, si dhe faktin që Klubi, përmes deklaratës së tij, ka reflektuar një pranim të pjesshëm të përgjegjësisë.

Gjithashtu, KD ka marrë parasysh se qëllimi i masave disiplinore është jo vetëm ndëshkues, por edhe edukues dhe parandalues, si dhe nevojën për vendosjen e një standardi të qartë për raste të ngjashme në të ardhmen.


Në përputhje me Nenin 47, alineja 2.2 të Rregullores Disiplinore, për shkelje të tilla organizatat sportive mund të dënohen me dënim me të holla prej 300.00 EUR deri në 2,000.00 EUR.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit, KD vlerëson se masa minimale financiare prej 300.00 EUR është e arsyeshme dhe e mjaftueshme në këtë rast.

KD thekson se ky dënim transmeton një mesazh të qartë se deklarata publike të tilla, përmes të cilave adresohen pakënaqësi ndaj vendimeve të organeve të FBK-së, rrjedhës së garës apo elementeve të administrimit të saj jashtë kanaleve zyrtare, nuk tolerohen. Në të njëjtën kohë, Komisioni nënvizon karakterin edukues dhe parandalues të masës disiplinore, duke synuar vendosjen e një standardi për respektimin e procedurave institucionale dhe ruajtjen e integritetit dhe besueshmërisë së garës. Në rast të përsëritjes së shkeljeve të ngjashme, KD do të shqiptojë masa më të rrepta në përputhje me dispozitat e Rregullores Disiplinore.

Bazuar në të gjitha si më sipër, Komisioni Disiplinor vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor:



Afrim Kamishi
Anëtar



Omer Daku
Kryetar



Blerim Vuniqi
Anëtar

Prishtinë, 4 maj 2026

Vendimi i dërgohet:

- KB Proton Cable Prizreni
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor
- Arkivit të FBK-së



Këshilla Juridike:

Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën prej 300€, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.